


Aktiviteti i BEI-t në BALLKANIN PERËNDIMOR 2022



- BEI Globale, krahu i zhvillimit të Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), investoi 835,2 milionë euro në Ballkanin Perëndimor* në vitin 2022.
- Ky financim pritet të mobilizojë një total prej pothuajse 3,5 miliardë eurosh në investime.
- Banka e BE-së ka qenë një kontribues kyç në Planin Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit Evropian prej 30 miliardë eurosh për rajonin përmes mbështetjes së saj për projektet e infrastrukturës së transportit dhe synon të luajë një rol kryesor në prezantimin e një pakete të mbështetjes energjetike prej 1 miliard eurosh në vitin 2023.
- Grantet e asistencës teknike të BEI Globale arritën në 11.2 milion euro për infrastrukturën e qëndrueshme, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, arsimin, energjinë e rinovueshme dhe projektet e efikasitetit të energjisë.



Në vitin 2022, banka krijoi BEI Globale, një krah i ri investimi i dedikuar vendeve dhe rajoneve përtej Bashkimit Evropian. Nën strukturën e re organizative, banka përmirësoi aktivitetet e saj në Ballkanin Perëndimor, duke vijuar me projekte që u përgjigjen nevojave infrastrukturore dhe sfidave që rrjedhin nga krizat globale të energjisë, ushqimit dhe klimës.

Si pjesë e "Team Europe", BEI Globale punoi në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe partnerët financiarë për të krijuar partneritete të reja dhe mundësi financiare novatore për të mbështetur tranzicionin e gjelbër, për të forcuar sigurinë e energjisë dhe për të promovuar digjitalizimin. Fokusi i BEI Globale mbetet përmirësimi i lidhjes rajonale duke modernizuar infrastrukturën jetike, duke forcuar rritjen e sektorit privat dhe duke mbështetur reformat për anëtarësimin në BE. Si pjesë e nismës "Global Gateway" të Bashkimit Evropian**, banka e BE-së vijoi të mbështesë zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit Evropian në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, së bashku me delegacionet lokale të BE-së, institucionet dhe organizatat financiare ndërkombëtare dhe partnerët vendas.



* Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

** "Global Gateway" është një strategji e re evropiane për të forcuar lidhjet inteligjente, të pastra dhe të sigurta në sektorët digjitalë, të energjisë dhe transportit dhe për të forcuar sistemet e shëndetësisë, arsimin dhe kërkimit në mbarë botën. Ai synon të mobilizojë deri në 300 miliardë euro për projekte të qëndrueshme të infrastrukturës në mbarë botën.



Siguria energjetike dhe agjenda e gjelbër

BEI Globale është në përputhje me paketën e BE-së për mbështetjen e energjisë për rajonin

Në përgjigje të krizës energjetike të përkeqësuar nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia, Bashkimi Evropian miratoi një paketë mbështetjeje energjetike prej 1 miliard eurosh për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor të përmbushë më lehtë nevojat e menjëhershme, afatshkurtra dhe afatmesme për energji, të përshpejtojë dekarbonizimin dhe të përmirësojë sigurinë energjetike. Qëllimi është të mbrohen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe familjet më të cenueshme, duke çuar përpara diversifikimin dhe efikasitetin e energjisë dhe prodhimin e energjisë së rinovueshme.

BEI Globale luan një rol kyç në zbatimin e paketës së BE-së për mbështetjen e energjisë. Prandaj, ajo ka përforcuar ekipin e saj rajonal në katër zyrat e saj në Ballkanin Perëndimor, për të ofruar mbështetje praktike dhe një përzierje gjithëpërfshirëse të huadhënies, përzierjes dhe shërbimeve këshillimore për të ndihmuar në përgatitjen e projekteve të reja që përfshijnë energjinë e rinovueshme, zgjerimin e rrjeteve të energjisë elektrike dhe infrastrukturën e magazinimit të energjisë, si dhe prezantimin e masave për efikasitetin energjetik.

Fillimi i projekteve të qëndrueshme të energjisë së rinovueshme me burimeve efikase

Grante me vlerë rreth 11,2 milionë euro për asistencë teknike

BEI është banka e BE-së për klimën. Si pjesë e saj, BEI Globale vijon financimin e projekteve të qëndrueshme për mjedisin, duke nënshkruar kështu hua me vlerë 835,2 milionë euro në vitin 2022, mbi 80% e të cilës ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në masat për klimën. Këto fonde do të ndihmojnë në ndërtimin e hekurudhës "Korridori X" në Serbi, modernizimin e pjesës së linjës evropiane hekurudhore 10 në Kosovë dhe përmirësimin e lundrimit në rrugë ujore të brendshme përgjatë lumenjve Savë dhe Danub. Në Maqedoninë e Veriut, rreth 700 000 njerëz do të përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet, e cila do të zbatohet në 80 komunat e vendit.

Përveç kësaj, BEI Globale mobilizoi grante të asistencës teknike në vlerë prej 11,2 milionë eurosh për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të reja. Për shembull, asistencë teknike për një projekt strehimi social në Tiranë do të rezultojë në ndërtimin e strehimeve të përbalueshme dhe me efikasitet energjie për rreth 6500 individë. Në Kosovë, BEI Globale nënshkroi një marrëveshje për asistencë teknike në vitin 2022 për të ofruar rekomandime për përmirësimin e infrastrukturës dhe standardeve të arsimit të lartë. Një marrëveshje tjetër u nënshkrua me qytetin e Nishit, Serbi, sipas së cilës BEI Globale do të sigurojë një plan të përshtatur për lëvizjen e qëndrueshme urbane për të siguruar ndërtimin e një rrjeti transporti të sigurt, të përshtatshëm dhe të gjelbër. Në Bosnjë-Hercegovinë, asistencë teknike globale e BEI-t do të lehtësojë ndërtimin e një centrali me erë 50 MW në rajonin e Travnikut, duke përshpejtuar kalimin drejt burimeve të rinovueshme, të sigurta dhe të qëndrueshme të energjisë.

Qytetet në Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë do të përfitojnë gjithashtu nga Fondi i Hendekut të Financimit për Klimën në Qytete, i cili ndihmon qytetet në mbarë botën të realizojnë ambicidet e tyre klimatike duke i kthyer idetë e qëndrueshme ndaj klimës në strategji dhe projekte të gatshme për financim.

"Si pjesë e "Team Europe", BEI Globale ka kënaqësinë të mbështesë rajonin në përgjigjen ndaj nevojave të zhvillimit urban dhe të infrastrukturës në një mënyrë e cila është e qëndrueshme financiarisht, gjithëpërfshirëse për shoqërinë dhe me efikasitet energjetik. Këto grante janë dëshmi e mëtejshme e angazhimit tonë për të nxitur zhvillimin e Ballkanit Perëndimor me energji të sigurt dhe neutrale ndaj klimës, si dhe për të ndihmuar rajonin të përafrohet me standardet e BE-së dhe të luftojë ndryshimet klimatike," - tha zëvendëspresidentja e BEI-t, Lilyana Pavlova.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Partner i besueshëm i sektorit privat

Që nga viti 2020, BEI Globale ka investuar 970 milionë euro në bizneset e vogla

Rimëkëmbja dhe rritja e sektorit privat, krijimi i vendeve të punës dhe dekarbonizimi mbeten ndër prioritetet kryesore të BEI Globale. Në bashkëpunim me institucionet kombëtare të zhvillimit dhe bankat tregtare, banka e BE-së ofroi mundësi të reja për të përmirësuar aksesin në financime të përballueshme për bizneset e vogla që përballeshin me kufizime financiare për shkak të efektit të ndërlikuar të krizës së energjisë dhe ushqimit, si dhe pasojave të pandemisë së koronavirusit.

Në vitin 2022, BEI Globale prezantoi huanë e saj stimuluese me ndikim, duke nxitur sipërmarrjen e grave dhe duke inkurajuar kompanitë të punësojnë njerëz nga grupet e cenushme sociale në Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë nëpërmjet bankave tregtare partnere. Për të ndihmuar bizneset e vogla të rrisin efikasitetin e tyre energjetik në përgjigje të krizës energjetike, BEI Globale krijoi një linjë të dedikuar kredie për veprime klimatike me Bankën për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut dhe Fondin e Zhvillimit të Investimeve të Malit të Zi. Këto fonde tashmë po ndihmojnë kompanitë të transformojnë biznesin e tyre drejt një modeli neutral ndaj klimës, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Në dhjetor 2022, Fondi Evropian i Investimeve (FEI), pjesë e Grupit të BEI-t, njoftoi Instrumentin e Garancisë për Zhvillimin dhe Inovacionin e Ndërmarrjeve në Ballkanin Perëndimor, me financim prej 60 milionë eurosh, për të siguruar akses në financim me kushte të favorshme për rreth 4 000 biznese të vogla në rajon. Garancia pritet të zhblllokojë një portofol gati shtatë herë më shumë se burimet e alokuara (rreth 400 milionë euro) dhe të ofrojë mbështetje thelbësore për të ndihmuar firmat e vogla dhe të mesme vendase të kenë akses në kredi, të rrisin qëndrueshmërinë e tyre dhe të forcojnë aftësitë ndërkohë që ato lëvizin drejt një ekonomie më të qëndrueshme dhe me më pak karbon.

Në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor, Grupi i BEI-t paraqiti propozime për disa instrumente financiare inovative dhe mbështetje këshillimore në kuadër të Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus për të nxitur një tranzicion të gjelbër, digjital dhe të drejtë midis bizneseve të vogla dhe të mesme. Grupi i BEI-t do të vijojë të ofrojë mundësi të reja investimi për të ndihmuar në tërheqjen e financimit privat për sipërmarrjet dhe aktivitetet filantropike që kontribuojnë në qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. FEI pret të mbështesë një portofol të përgjithshëm prej rreth 1 miliard euro për bizneset e vogla sipas një sërë skemash midis 2024 dhe 2026.



ARRITJET E GRUPIT TË BEI NË VITIN 2022

Financimi i përgjithshëm i Grupit të

BEI-t

Projektet e financuara nga Grupi i BEI-t
me vlerë

72,5 miliardë euro

Financimi i projekteve të gjelbra Mbi 50%

e të gjitha financimeve të nënshkruara nga Grupi
i BEI-së lidhen me veprimet për klimën dhe
qëndrueshmërinë mjedisore

Projektet e nënshkruara

nga BEI Globale për Ballkanin Perëndimor
arritën vlerën

824 milionë euro

Grantet e nënshkruara

për projektet e reja në Ballkanin Perëndimor arritën
gjithsej

11,2 milionë euro

Projektet e nënshkruara

nga Grupi i BEI-t për Ballkanin Perëndimor që prej
vitit 2009 arritën

10,3 miliardë euro

Numri i vendeve të punës

të ruajtura që prej vitit 2009 me ndihmën e
financimit të BEI-t tejkaloi

900 000

PIKA KONTAKTI PËR SHYTPIN

Gordana Kovačević
+381 60 323 3435
+381 11 312 1756
g.kovacevic@ext.eib.org

**Përfaqësia Rajonale për
Ballkanin Perëndimor**
Vladimira Popovića 38
Belgrade, Serbia
+381 11 312 1756
belgrade@eib.org

Zyra e Shtypit
+352 4379 21000
+352 4379 61000
press@eib.org
www.eib.org/press

PIKA TË PËRGJITHSHME KONTAKTI

Banka Evropiane e Investimeve
98-100 boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luxembourg

Këndi i Informacionit
+352 4379 22000
+352 4379 62000
info@eib.org – www.eib.org